



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance*

*Thesari/Trezor/Treasury*

## **TË DHËNAT TRE-MUJORE MBI BORXHIN E PËRGJITHSHËM**

Shtator 2014

## Përmbajtja

SHKURTESAT .....	3
BORXHI I PËRGJITHSHËM .....	4
Portofoli i borxhit sipas valutës.....	5
Portofoli i borxhit sipas llojit të interesit .....	5
BORXHI NDËRKOMBËTAR .....	6
BORXHI I BRENDSHËM .....	7
INDIKATORËT E RREZIKUT .....	7

## SHKURTESAT

BPV	- Bruto Produkti Vendor
FMN	- Fondi Monetar Ndërkombëtar
IBRD	- Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në kuadër të Bankës Botërore
IDA	- Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim në kuadër të Bankës Botërore
KfW	- Banka Zhvillimore në kuadër të Republikës Federale të Gjermanisë
SDR	- Të Drejtat Speciale për Tërheqje
TM	- Tre-mujor

## BORXHI I PËRGJITHSHËM

Duke u bazuar në Ligjin për Borxhet Publike nr. 03/L-175 dhe Rregulloren QRK mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive Shtetërore dhe Borxheve Komunale Nr. 22/2013, Thesari publikon raportin *Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm*. Borxhi i Përgjithshëm përkufizohet me Ligjin për Borxhin Publik si, tërësia e borxhit shtetëror dhe borxhit komunal.


Në fund të muajit shtator 2014 stoku i borxhit të përgjithshëm shënoi shumën 550.93 milion Euro apo 10.18% e BPV-së<sup>1</sup>, nga të cilat borxh i ndërkombëtar<sup>2</sup> 317.65 milion Euro apo 5.77% e BPV-së dhe borxhi i brendshëm 233.27 milion Euro apo 4.23% e BPV-së. Stoku i borxhit të përgjithshëm është në formë të Borxhit Shtetëror, të Nën-huazuar, dhe Garancive; Republika e Kosovës akoma nuk ka borxh komunal. Në tabelën 1 shihet borxhi i përgjithshëm, i ndarë sipas llojit.

**Tabela 1. Borxhi i Përgjithshëm (shumat janë në miliona euro)**

	2011	2012	2013	TM1 2014	TM2 2014	TM3 2014
<b>Borxhi Ndërkombëtar</b>	<b>253.60</b>	<b>336.60</b>	<b>323.76</b>	<b>317.58</b>	<b>318.95</b>	<b>317.65</b>
Niveli Qendror	253.55	336.46	321.73	314.38	315.05	313.09
Nën-huazimet	0.05	0.14	2.03	3.20	3.90	4.56
<i>Komunat</i>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Borxhi i Brendshëm</b>	<b>0.00</b>	<b>73.31</b>	<b>152.51</b>	<b>189.52</b>	<b>235.50</b>	<b>233.27</b>
Niveli Qendror	0.00	73.31	152.51	189.52	235.50	233.27
<i>Komunat</i>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm</b>	<b>253.60</b>	<b>409.92</b>	<b>476.27</b>	<b>507.10</b>	<b>554.45</b>	<b>550.93</b>
Garancitë Shtetërore	0.00	0.00	0.00	0.00	10.00	10.00
<b>Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV-së)</b>	<b>5.51%</b>	<b>8.44%</b>	<b>9.10%</b>	<b>9.20%</b>	<b>10.25%</b>	<b>10.18%</b>

Krahasuar me tremujorin e dytë borxhi i përgjithshëm në tremujorin e tretë ka pësuar një rënie të lehtë, siç mund të shihet në grafikonin 1.

**Grafikoni 1. Stoku i borxhit të përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së**




<sup>1</sup> Përfshirë Garancitë sipas Nenit 5, Ligji për Borxhet Publike nr. 03/L-175

<sup>2</sup> Tani e tutje borxhit të jashtëm do të ju referohemi si borxh ndërkombëtar

### Portofoli i borxhit sipas valutës

Në fund të muajit shtator 2014, rreth 75<sup>3</sup> milion Euro apo 14% e portofolit të borxhit është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor, kjo pasi që kreditë e huazuara nga FMN dhe IDA janë në valutë SDR<sup>4</sup>. Ndërsa, pjesa tjetër 86 % e portofolit të borxhit është në valutën Euro, siç shihet në grafikoni 2.


**Grafikoni 2. Përbërja e borxhit të përgjithshëm sipas valutës**



### Portofoli i borxhit sipas llojit të interesit

Pjesa e portofolit të borxhit e cila është e ekspozuar ndaj rrezikut të interesit përbëhet nga borxhi që i detyrohem FMN-së. Kështu në fund të tremujorit të tretë të 2014, 19% e portofolit të borxhit është i ekspozuar ndaj rrezikut të interesit, si shihet më poshtë në grafikoni 3.

**Grafikoni 3. Përbërja e borxhit të përgjithshëm sipas llojit të interesit**




<sup>3</sup> Është vlera neto e ekspozuar, e cila nënkupton shumën e ekspozuar duke përjashtuar komponentin Euro.

<sup>4</sup> SDR është një 'shportë' monedhash e cila përbëhet nga monedhat e mëposhtme: EUR, USD, GBP, dhe JPY. Vlera e SDR përcaktohet në bazë të një mesatare e cila është tërhequr nga vlerat e monedhave të përmendura më lart.

## BORXHI NDËRKOMBËTAR


Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014 borxhi ndërkombëtar ishte 317.65 milion Euro, që njëherazi përbën 57.7% të portofolit të borxhit. Pjesa më e madhe e borxhit vazhdon të jetë ndaj IBRD-së, ndërsa pjesa tjetër e konsiderueshme është borxh ndaj FMN-së. Në grafikun 4 shihet përbërja e borxhit ndërkombëtar sipas kreditorëve.

**Grafikoni 4. Borxhi ndërkombëtar i ndarë sipas kreditorëve**



Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014, pjesa më e madhe e borxhit ndërkombëtar ishte kryesisht në valutën Euro, kurse pjesa tjetër në SDR. Kryesisht kreditë e huazuara nga IDA dhe FMN janë në valutën SDR, kurse kreditë nga IBRD, KfW<sup>5</sup> dhe UniCredit Austria janë në valutën Euro.

**Grafikoni 5. Borxhi ndërkombëtar sipas valutës**




<sup>5</sup> Kreditanstalt für Wiederaufbau

## BORXHI I BRENDSHËM

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014 borxhi i brendshëm ishte në shumën 233.27 milion euro apo 42.3% e portofolit të borxhit. Në vijim në grafikoni 6 shihet kompozimi i borxhit të brendshëm sipas instrumentit.

**Grafikoni 6. Borxhi i brendshëm i ndarë sipas llojit të instrumentit**



## INDIKATORËT E RREZIKUT

Në fund të tremujorit të tretë, disa prej indikatorëve të portofolit të borxhit kanë pasur ndryshime lehta në krahasim me tremujorin e dytë, si shihen në tabelën 2.

**Tabela 2. Indikatorët e rrezikut**

	2012	2013	TM1 2014	TM2 2014	TM3 2014
<b>Borxhi i përgjithshëm/BPV<sup>6</sup></b>	8.44%	9.1%	9.2%	10.25%	10.18%
<i>Borxhi Ndërkombëtar</i>	6.93%	6.17%	5.76%	5.97%	5.77%
<i>Borxhi i Brendshëm</i>	1.51%	2.91%	3.44%	4.28%	4.23%
<b>Koha mesatare deri në maturim për borxhin e përgjithshëm (vite)</b>	11.51	9.24	8.48	4.78*	5.47
<i>Borxhi Ndërkombëtar (vite)</i>	14	13.42	13.28	7.91*	7.99
<i>Borxhi i Brendshëm (muaj)</i>	1.53	4.28	5.77	6.68	7.44
<b>% e Borxhit të Përgjithshëm</b>	100%	100%	100%	100%	100%
<i>Borxhi Ndërkombëtar</i>	82.12%	67.98%	62.62%	57.52%	57.66%
<i>Borxhi i Brendshëm</i>	17.88%	32.02%	37.38%	42.48%	42.34%

<sup>6</sup> Përfshin edhe Garancitë

\* Ndryshim në Metodologji – Llogaritja e mëparshme është bërë duke marrë për bazë datën e pagesës së kështit të fundit. Kurse tani e tutje llogaritja bëhet duke marrë për bazë datat aktuale të pagesës së secilit kësht.